

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndertim i Ujesjellesit ne fshatrat Urake-Kotodesh-Katjel, Njesia Administrative Rrajce”, Bashkia Prrenjas

“

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):

45247130-0 Punime ndertimi per Ujesjelles

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **202 444 113.24** (dyqind e dy milion e katerqind e dyzet e kater mije e njeqind e trembedhjete pike njezet e kater) leke pa tvsh Monedha, pa TVSH TVSHi ndare ne vitet financiare

Viti 2026: 47 146 504.17 (dyzet e shtate milion e njeqind e dyzet e gjashte mije e peseqind e kater pike shtatembedhjete) leke pa Tvsh

Viti 2027: 70 719 756.67 (shtatedhjete milion e shtateqind e nentembedhjete mije e shtateqind e pesedhjet gjashte pike gjashtedhjet e shtate) leke pa Tvsh

Viti 2028:80 577 852.40 (tetedhjet milion e peseqind e shtetdhjet e shtate mij e teteqind e pesedhjet e dy pike dyzet) leke pa Tvsh

Argumentim I Autoritetit Kontraktor

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 45 ku kërkohet“Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos,autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë,si dhe peshën specifike për secilin kriter,konkretisht,pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm.,vlerësojmë si më poshtë:

Së pari në DST Kapitulli 4.4“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më e favorshme,bazuar në kosto **X**

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ x

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □□	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë □□	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □□	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 12 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
- I Kohën e mobilizimit në kantier (**jo me shume se 2 muaj**) [2 pike].
- II Grafiku i punimeve të Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k2a}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2a}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga

stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin **2.3** / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Kualifikimi I stafit Kyc dhe eksperiencia ne fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i ketij nenkriteri do te realizohet sipas percaktimeve me poshte:

I. Deshmi qe stafi disponon diplome universitare [6 pike]

II. Deshmi qe stafi disponon pune te ngjashme me objektin e prokurimit [4 pike]

III. Deshmi qe stafi disponon experience mbi 1(nje) vit pune [2 pike]

IV. Deshmi qe stafi disponon eksperiencia ne natyre/kompleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [1 pike]

Per permbushjen e kritereve te mesiperme duhet te dorezohet CV dhe deshmi/reference/dokumentacion te leshuar nga punedhenes te meparshem ose perfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **202 444 113.24** pa tvsh e fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 e Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik ku përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në :b) **gjendjen ekonomike dhe financiare ;...** 3)Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë **një xhiro vjetore minimale të caktuar**. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin **informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Përmiratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet: “Autoritetit kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare.**”

Ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera **202 444 113.24** lekë pa TVSH e fondit limit të kontratës që prokurohet.

:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Nëse vlerësohet, Autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vite të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Gjithashtu, për caktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nëudhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat ”, i ndryshuar pika 3.12 etij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr.25 datë 10.05.2018** “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ” neni 9 i tij ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit , miratohen nga ministri përgjegjës për financat”.

Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilitetit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Komisioni përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **80 977 645.29** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **404 888 226.48** lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Aktin e Kolaudit të objektit
- d) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
- e) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

- a) Kontratën e Sipërmarrjes,
- b) Situacionin përfundimtar të objektit
- c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d) Aktin e Kolaudit të objektit

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" ku përcaktohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burime të nevojshme njerëzore e

teknike,si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore,në veçanti,mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një.Nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”**

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”pika 5 dhe 8 te VKMNr. 285datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,të ndryshuar ku përcaktohet se:“Për të provuar përvojën e mëparshme,autoriteti/enti kontraktor kërkon:**a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;b)punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera,e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit,është jo më e madhe se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/entikontraktor,si dëshmi për përvojën e mëparshme,kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti /enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime,për përmbushjen me sukses të kontratës,ku të shënohen vlera,afati I përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë,e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi ,që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor,përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat I vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Autoriteti Kontraktor përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme,janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës.**Përvoja te mëparshme** janë element shumë i nevojshëm,që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën mesukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Kriterii kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë.Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë mëparshme të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje.Përvojat më parshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situatë të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatë të mundshme në mënyrën e duhur.Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e njëkonkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni,AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve,bazuar në Ligjin Nr.840datë10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(I ndryshuar),si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që poprokurohet është në bazë të punimeve me matje,sipas nenit 39pika1/a e VKM-së,lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39pika 5/a dhe b,të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike.Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës,ku punime të mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zëra të punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punime të mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë,nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim,në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto tëfundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm,nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës,por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre,duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit,pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar),A K gjykon se

kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Ndërsa me ndryshime të reja ligjore përkatësisht VKM Nr. 498, datë 01.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, Neni 16 ku parashikohet “Në paragrafin e fundit, të pikes 5, të nenit 39, “Kërkesatë veçanta për kontratat për punë publike”, pas fjalëve “...e shoqëruar me fatura tatimore...” shtohen “...të **deklaruar në organet tatimore...**” u kërkuar që në kërkesën e bërë përpunime të ngjashme të kryera dhe të realizuara me sektorin privat: si dëshmi përpërvijën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, të paraqiten vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të vlefshme të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-1 C** Punime gjërmimi në tokë
- **NP-4 A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP-7 C** Ujësjellës, gazjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;
- **NP-11 A** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **NP-12** Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **Kategoria NS- 1** Punim për prishjen e ndertimeve **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 4** Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik, dhe xhami dhe rifiniture e natyrës teknike ndertuese **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS- 9** Punime strukturore speciale **Klasifikimi B**
- **Kategoria NS-14** **Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV:** Klasifikimi A
- **Kategoria NS-16** Ndërtimi i Impiantëve të ujërave pijshëm dhe pastrimit të tyre **Klasifikimi B**
- **Kategoria NS-18** Punime topogjeodezike **Klasifikimi B**

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr. 42, datë 16.01.2008 (i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹”, të ndryshuar, në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**; ... Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistruhen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe

profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burime te nevojshme** njerëzore e **teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021“Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/entikontraktorkërkon:a)**licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr.42 datë 16.01.2008 e ndryshuar“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedura të dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”(lidhja 2,3 dhe 4).Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate,në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar),si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,AK vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatim të punimeve,kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve,si dhe klasifikimin në nivele të kërkuara për çdo kategori punimesh,kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës.Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre,sipas kategorive dhe niveleve (gërmave)përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respective dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Niveli i klasifikimit për kategoritë respective është kërkuar duke u bazuar në zëra të punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008,të ndryshuar.si me poshte :

Kategoritë e licencave me sipër teknikisht argumentohet:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorise sipas legjislacionit te fushes</i>	<i>Zerat e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv qe perfshihen ne kategorine perkatese</i>	<i>Niveli i klasifikimit te kerkuar per kategorine respektive</i>	<i>Vlera e punimeve qe parashikohen te kryhen ne preventiv, qe perfshihen ne kategorine perkatese</i>
NP- 1 C	Punime gërmimi në tokë	2.Punime Germimi 3.Punime Dheu 16 .Punime Shtresash	51-100 milion leke	Nuk e kalon vlerën 100 milion
NP-4A	Rruge autostrada,ura, mbikalime ,hekuridha ,linja tramvaji,metro,h ekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale	3.Punime shtresash 11.Analiza Teknike	0-20 milion	Nuk e kalon vlerën 20 milion

NP-7-C	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje”	14.Instalime Hidro-Sanitare dhe ngrohje 15.Gaz e Naftesjelles 20.Ujesjelles e Kanalizim i jashtem 21.Analiza jashte liste	<i>51-100 milion</i>	Nuk e kalon vleren 100 milion
NP-11 A	Ndertim per nenestacione,kab inat e transformacionit linjat T/N dhe tension te mesem dhe shperndarjen e energjise elektrike	20. Instalime per ndricim	<i>0-20 milion</i>	Nuk e kalon vleren 20 milion
NP-12B	Punime inxhinierike mjedisore	Konsiderohen ndertime mirembajtje dhe rsitrukturime dhe punime te vecanta per vete specifiken e projektit ka ndikim te drejperdrejte ne mjedis ne te gjitha kategorite e punimeve qe do te kryhen ka prishje dhe rikthim ne gjendjen fillestare te te gjitha siperfaqeve mjedisore qe do te preken nga ky ndertim si dhe duke mare parasysh sasine e madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve,germimet e dheut etj.	<i>21- 50milion</i>	<i>Nuk e kalon vleren 50 milion</i>
NS-1-A	Punim per prishjen e ndertimeve	9.Prishje	<i>0-20 milion</i>	<i>Nuk e kalon vleren 20 milion</i>
NS-4-A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to,rifiniture me materiale druri,plastik ,metalik,dhe xhami dhe rifiniture e natyres teknike ndertuese	13. Punime tavani + suvatim 14. Punime bojatisje 15. Punime dyer dritare 18. Punime murature tulle 19.Nenshtresa dhe shtresa ne territotin e ndertesave	<i>0-20 milion</i>	<i>Nuk e kalon vleren 20 milion</i>

NS-9-A	Punime strukturore speciale	4.Punime betoni dhe b/a 5.Punime hekur betoni 6.Ndertim vepra arti + Kanalizime 7.Punime hidroizolimi dhe Catite 8. Punime shtresash 2 12.Punime \hekur betoni 3	0-20 milion	Nuk e kalon vleren 20 milion
NS-14A	Impiante brendshme të elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV:	21. Analize jashte liste F.V. Sistem i plotë kamerë sigurie solar PTZ, IP66, me panel fotovoltaike dhe bateri të integruar, përfshirë furnizimin, transportin, montimin, strukturën mbajtëse, aksesoret, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë >	0-20 milion	Nuk e kalon vleren 20 milion
NS-16A	Ndertimi i Impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij	Ndertimi i impianteve të ujit të pijshëm të kompletuar me cdo punim të lidhur me muraturen plotësuese ose ndihmese ose të vecanta ose në rrjet	0-20 milion	Nuk e kalon vleren 20 milion
NS-18-B	Punime topogjeode zike	Raporti topografik të hartuar nga projektuesi, kontraktori duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit për të realizuar specifikimet teknike të objektit, duke plotësuar saktësinë e realizimit të piketimit.	21-50milion	Nuk e kalon vleren 50 milion

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 39, pika 6/a, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1 C Punime gjurmimi në tokë: Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmimi në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është C. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 100 milion leke

N.P-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me rehabilitimin në rrugë ndaj është e

nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke

N.P-7 C Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen për ujësjellës, kanalizime etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë N.P-7 , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është C . Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 100 milion leke

N.P-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me spostime shtylla elektrike përfshirë dhe linjat, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke

N.P-12 B Punime të inxhinierisë mjedisore: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 50 milion leke.

N.S-1A Punime për prishjen e ndërtimeve: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje muri blloqe betoni, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë NS-1A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke.

N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese:

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Vendosija në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke.

N.S-9 A Punime Strukturore Speciale: Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke.

N.S- 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV:

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke

N.S-16 A Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij:

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, nuk e kalon vlerën 20 milion leke.

N.S-18 B Punime topogjeodezike: Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen Punime topogjeodezike, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Kërkesa për licencë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, të cilat kërkojnë piktet, nivelim dhe kontroll të saktë gjeometrik gjatë zbatimit të projektit ujesjellesit dhe linjave të tij. Kjo licencë garanton kapacitetet teknike për realizimin korrekt të punimeve dhe përputhshmërinë me projektin. Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 21-50 milion leke

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë;
- c) Libreze pune.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi

Vendimin nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit” ku përcaktohet se: “1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, KREU IV pika 2, germa b) ku përcaktohet: Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë liçencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit; dhe KREU III, pika 3, germa “c” ku përcaktohet se: “Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.4 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik	2 (dy)
- Inxhinier Gjeoinformatik	1 (një)
- Inxhinier Hidrogeolog	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik	1 (një)

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Staf teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

1 Inxhinier Ndërtimi: Referuar preventivi të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-1, N.P-4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit, përfshirë shtresat rrugore, trotualet dhe elementët përbërës, ku kalojnë tubat e shpërndarjes në fshtarat URAKË - KOTODESH -KATJEL duke garantuar zbatimin korrëkt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

2 Inxhinier Hidroteknik: Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Kërkohet për projektimin/zbatimin dhe kontrollin e sistemit të ujërave, për vendosjen në funksion vëprës hidrike, të domosdoshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë së trupit të rrugës dhe shmangien e dëmtimeve. **Kërkesa për 2 inxhinier Hidroteknik është e nevojshme për arsye sepse vepra ka gjatëse të konsiderueshme dhe shtrihet në 3 fshatra URAKË - KOTODESH -KATJEL në distance nga njëri-tjetri.**

2 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: Referuar preventivi të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **N.P-4, N.P-7, NS 18**. Kërkesa për 2 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik është e domosdoshme pasi ai siguron zbatimin e saktë të projektit në terren, duke përcaktuar kordinatat, kuotat, piketimet dhe gjurmën e rrugës orientuar me kuotat e objekteve civile, saktësinë e gjurmës së linjave, volumin e gërmimeve etj. Ata kontrollojnë nivelimet dhe parametrat teknikë gjatë gjithë fazave të punimeve, si dhe realizon matjet për volume dhe situacione. Prania e tij garanton cilësi, shmang devijimet nga projekti dhe është thelbësore për realizimin korrëkt dhe sipas standardeve të punimeve për gjurmen ku është përcaktuar projekti sipas kuatave që duhen respektuar për vendosjen në funksion të veprës për furnizimin me ujë të fshatrave.

1 Inxhinier Hidrogeolog: Analizon ndikimin e ujërave nëntokësore mbi strukturën e rrugës që është parashikuar për tu hapur për të shkuar të vendëburimi i ujit që do të bëhet furnizimi me ujë, duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve që mund të vijnë nga infiltrimi apo lagështia e vazhdueshme.

Prezenca e tij është e domosdoshme pasi në terrenin ku do të ndërtohet është në afërsi të **ligjeni të Prrenjasit** dhe ka prezencë uji si zona më e ulët ujëmbledhëse/Burimi i cili ndodhet në një lartësi **725.6 m mbi nivelin e detit në Qaf-Thanë**, i cili do të krijojë dëstabilitet në ndërtimin e rrugës si dhe çarjen e strukturës së saj për kalimin e tubit i cili do të marrë ujë. Pra duke qenë se kjo zonë është problematike për ujrat nëntokësore dhe shpesh herë kemi hasur prishje të strukturave të rrugëve që janë ndërtuar, inxhinieri do të gjejë zgjidhje për

largimin e ujit si dhe rrugët e kalimit të tij për mos t'u krijuar probleme të mëvonshme në funksionimin e veprës kaq të rëndësishme.

1 Inxhinier Mekanik do të jetë përgjegjës për punimet mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve sic janë montimet e pjesëve speciale të celikut, Konstruksiione metalike të thjeshta , mates uji mekanik , Fllanxe adaptor Gize etj .

1 Inxhinier Gjeoinformatik mund të përdorë teknologji të avancuara ose skanimin 3D për të krijuar modele të sakta të terrenit ku do të ndërtohet objekti. Sistemet kompjuterike të përdorura nga Ing. gjeoinformatike, mund të analizojnë karakteristikat gjeologjike dhe mjedisore të terrenit për të përcaktuar nëse toka është e përshtatshme për ndërtim dhe për të planifikuar masat për menaxhimin e rrezeve (si p.sh., rrëshqitjet e dheut ose përmbytjet). Kjo mund të ndihmojë për të parë më mirë ndikimin e projektit në mjedis dhe për të identifikuar probleme potenciale që mund të lindin gjatë ndërtimit.

1 Inxhinieri i Ndërtimit profili gjeoteknik: studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelimin dhe shtresat rrugore, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet të tokës gjatë hapjeve të kanaleve për vendosjen e tubave/ linjave te ujësjellësit.

Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e testeve gjeoteknike dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendit për ndërtim. Testet ofrojnë të dhëna të çmuara mbi vetitë fizike dhe mekanike të dheut, duke përfshirë llojin, fortësinë, densitetin, përshkueshmërinë, porozitetin dhe kompaktimin, ndër të tjera. Kuptimi i këtyre karakteristikave ndihmon inxhinierët të parashikojnë sjelljen e dheut nën kushte të ndryshme ambientale dhe ngarkesa, dhe i mundëson ata të projektojnë themelin e strukturës në mënyrë efektive dhe të sigurt. Ai udhëzon zgjedhjen e metodës së duhur të ndërtimit dhe materialeve që do të përdoren. Së fundi, ai ndihmon në kursimin e kostove duke zvogëluar rrezikun e dështimit struktural që mund të çojë në veprime korrektive të kushtueshme. Studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelimin dhe shtresat e tokës, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet gjatë shfrytëzimit të objektit që mos të krijojë spostime të linjave të tubave duke sjell më pase ne defekte .

Parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve,kërkesat e mësipërme janë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën pr ofesionale të shoqërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë staf mbështetës si më poshtë:

- | | |
|--------------------------|---------|
| - Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidrogjeolog | 1 (një) |
| - Inxhinier Materialesh | 1 (një) |

Stafi i sipërcituar duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit si dhe duhet të paraqesë dokumentacionin: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Shënim: Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë

AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentim: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

1 Inxhinier Elektrik: Kërkohet për realizimin dhe mbikëqyrjen e instalimeve elektrike që lidhen me shumen **20. INSTALIME PER NDRICIM** elektrike dhe elementë të tjerë elektrikë, duke siguruar funksionalitet dhe përputhshmëri me standardet teknike.

1 Inxhinier Hidrogeolog: Analizon ndikimin e ujërave nëntokësore mbi strukturën e rrugës që është parashikuar për tu hapur për të shkuar të vendeburimi i ujit që do të bëhet furnizimi me uje, duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve që mund të vijnë nga infiltrimi apo lagështia e vazhdueshme.

Prezenca e tij është e domosdoshme pasi në terrenin ku do të ndërtohet është në afërsi të ligjeni te Prrrenjasit dhe ka prezencë uji si zona më e ulët ujëmbledhëse/Burimi i sili ndodhet në një lartësi 725.6 m mbi nivelin e detit në Qaf-Thanë, i cili do të krijojë dëstabilitet në ndërtimin e rrugës si dhe çarjen e strukturës së saj për kalimin e tubit i cili do të marrë ujë. Pra duke qenë se kjo zonë është problematike për ujrut nëntokësore dhe shpesh herë kemi hasur prishje të strukturave të rrugëve që janë ndërtuar, inxhinieri do të gjejë zgjidhje për largimin e ujit si dhe rrugët e kalimit të tij për mos t’u krijuar probleme të mëvonshme në funksionimin e veprës kaq të rëndësishme.

1 Inxhinier Materialesh është e nevojshme prezencja e një Inxhinieri materialesh pasi në preventiv janë parashikuar punime për materiale të betonit dhe asfaltobetonit që do të jenë në prezencë të vazhdueshme të ujerave sipërfaqesore dhe nëntokësore në shpatin e malit , gjithashtu do të bëhet përzgjedhja e materialit që do të furnizohet tubat e ujesjellesi, saracineska, ajeruesit dhe cdo materialet tjetër që është i nevojshme sipas specifikimeve teknike . Rëndësia e cilësisë së materialeve që do të përdoren në këtë objekt është e lartë ndaj lind nevoja e një specialisti për përzgjedhjen dhe vendosjen e tyre në vepër.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

a) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me çertifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, e lëshuar nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

b) **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH. shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Shënim: Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar sipas të cilit: “1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

b) **1 (një)** specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH. shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se : ”Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.**

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **60 (Gjashtëdhjet)** punonjës për periudhën muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Permbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **60 (gjashtedhjet)punonjes**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet të jete mesatarisht të paktën **60 (gjashtedhjet)punonjes**. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim mesatarisht të paktën **60 (gjashtedhjet)punonjes** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukture së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

ARGUMENTIMI I NUMRIT TE PUNONJESVE

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtorë konkludojmë si mëposhtëm:

Total Dite pune punëtori= 264 dite pune

Dite pune gjithsej = 12 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 dite/muaj= 264 dite pune,

Numri i fuqisë punëtorë = 126 720 orë pune / (264x8ore/ dite) = 60 punëtorë/dite

Ne menyre te permbledhur numri i fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte minimumi 60 (gjashte dhjete)punonjes

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, me profesionet si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)	Diplomë të shkollës mesme
- Teknik Topograf	2 (dy)	Diplomë të shkollës mesme
- Teknik Hidroteknik	1 (një)	Diplomë të shkollës mesme
- Karpentierë	3 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Betonues	3 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hekurkthyes	3 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Bojaxhi	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Suvatues	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hidraulik	7 (shtatë)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Elektriciist	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Saldator	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Punëtorë asfalti	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Punëtorë të thjeshtë	5 (pesë)	

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

nr.	emër mbiemër i punonjësit	profesioni	institucioni public/privat lëshues i certifikatës/diplomës	nr. i certifikatës/diplomës	nr nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.					
2.					
etj.					

Shënim: Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/ certifikatë kualifikimi ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme). Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve:

- **Teknik Ndërtimi:** Kërkohet për mbikëqyrjen e punimeve ditore në terren, organizimin e ekipeve të punës dhe zbatimin korrekt të udhëzimeve të inxhinierëve, duke garantuar cilësinë dhe rendin në punime.
- **Teknik Topograf:** Tekniku topograf është i domosdoshëm në ndërtimin e një rruge sepse siguron trase të saktë, nivelime korrekte dhe përputhje me projektin. Ai kontrollon gjerësinë, pjerrësinë dhe kuotat e rrugës, duke shmangur gabime që mund të sjellin kosto shtesë dhe probleme në kullim apo siguri.
- **Teknik Hidroteknik:** Vendosja e teknikut hidroteknik është e justifikuar pasi punimet rrugore lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Prania e këtij specialisti garanton projektimin dhe zbatimin korrekt të sistemit të kanalizimeve, pusetave, duke parandaluar dëmtime si erozioni, infiltrimi dhe degradimi i shtresave rrugore. Përfshirja e tij si kriter siguron cilësi në realizim, rrit jetëgjatësinë e investimit dhe minimizon rreziqet teknike gjatë dhe pas ndërtimit. Në këtë mënyrë, autoriteti kontraktor garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm profesional për të përballuar të gjitha aspektet hidroteknike të projektit.
- **Hidraulik:** Të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas preventivit ku këto punime zënë pjesë të konsiderueshme, si furnizim vendosje tuba dhe rakorderi, punimet për rrjetin, punimet për puseta etj.
- **Karpentierë:** Të nevojshëm për ndërtimin e formave për beton, montimin e elementëve druri dhe strukturave të përkohshme, të cilat mbështesin punimet betonit sipas zërave të preventivit.
- **Betonues:** Të nevojshëm për ndërtimin e formave për beton, montimin e elementëve druri dhe strukturave të përkohshme, të cilat mbështesin punimet betonit sipas zërave të preventivit.

- **Hekurkthyes:** Për prerjen, përgatitjen dhe vendosjen e hekur, pjesë thelbësore e punimeve beton arme.
- **Elektricitist:** të cilët do të realizojnë punimet sipas preventivit tek, instalatore linje , instalimet per ndricim, shuma nr **20. INSTALIME PER NDRICIM** etj.
- **Bojaxhi :** të cilët do të realizojnë punimet sipas preventivit per lyerjen e objekteve shuma nr **14. PUNIME BOJATISJE**, etj
- **Hidroizolues:** të cilët do të realizojnë punimet sipas preventivit per hidroizolim shuma nr **7. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE**, etj
- **Suvatues:** të cilët do të realizojnë punimet sipas preventivit per suvatime ne objektin shuma nr **13. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI**, etj
- **Saldator:** për montimin e tabelave rrugore dhe elementeve të sinjalistikës. Ai shërben për bashkimin dhe fiksimin e strukturave metalike si shtyllat mbajtëse, kornizat dhe mbajtëset e tabelave, duke siguruar që ato të jenë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe ngarkesave të jashtme.
- **Punëtorë Asfalti:** Për shtrimin, nivelimin dhe përfundimin e shtresave asfaltore, duke siguruar cilësinë, nivelin dhe funksionalitetin e rrugës shuma nr **11. ANALIZA TEKNIKE**.
- **Punëtorë të thjeshtë:** Për ndihmë në transport materialesh, mbajtje rendi në punime, dhe aktivitetet ndihmëse të nevojshme për realizimin e kontratës, duke mbështetur ekipet teknike dhe specialistët.

Prezenca e këtyre punonjësve në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- 4 (katër) shofere të mjeteve te rënda/kamioni;
- 4 (katër) automakinistë;
- 2 (dy) eskavatoristë;
- 4 (katër) buldozeristë.

Ofertuesi për stafin e mësipërm duhet të paraqesë:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- d) Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Në rastin kur punonjësit Manovratorë, Ekskavatoristë, Shofer ose buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6, të VKM–së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Numri dhe kualifikimi i punonjësve të paraqitur në këtë ofertë është përcaktuar në përputhje me mjetet dhe makineritë e deklaruara për realizimin e kontratës. Çdo mjet i parashikuar shoqërohet me personelin përkatës teknik të nevojshëm për operimin e tij, duke garantuar funksionim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

Konkretisht, numri i shoferëve, manovratorëve, buldozeristit dhe automakinistëve është dimensionuar mbi bazën e numrit dhe llojit të makinerive të angazhuara, për të përballuar ngarkesën e punës dhe çdo situatë operative.

Kjo qasje garanton një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore në raport me kapacitetet teknike, duke rritur sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të punimeve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Në tërësi, këto kërkesa për staf minimal janë të justifikuara nga: Volumi dhe dinamika e punimeve; Nevoja për paralelizëm në procese; Respektimi i afateve kontraktuale; Garantimi i sigurisë në kantier; Cilësia e zbatimit sipas standardeve të ndërtimit të rrugëve.

Prandaj, vendosja e këtyre kriterëve në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të projektit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia	<i>Volumet</i>
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera	60501 m ³ germim 20167 m ³ transport
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera	13016 m ² materiale te ndryshme si 39 m ³ prishje betoni
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qera	Deri ne 32870 ml tubo Φ te ndryshme Furnizim puseta kontrolli , pjesë e materiale,etj
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 1.2-3.5	3 copë	Në pronësi ose me	Ngarkim

	Ton		qera	dherash dhe sistemim materiale dhe transport 6.4 ton hekur
5	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	1 copë	Në pronësi ose vme qera	
6	Minidumper me targa	1 copë	Në pronësi ose vme qera	
7	Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke	1 copë	Në pronësi ose vme qera	
8	Vinç me kosh me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera	
9	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	1 copë	Në pronësi ose me qera	
10	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera	
11	Kamiona vetëshkarkues me vinc me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera	
12	Rul ngjeshes gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira	
13	Fadrome me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera	
14	Minifadrome me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera	
15	Eskavator me zinxhir + Çekic Pneumatik	2 copë	Në pronësi ose me qera	60501 m ³ germim
16	Eskavator me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera	60501 m ³ germim
17	Minieskavator	2 copë	Në pronësi ose me qera	
18	Grejder me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera	
19	Asfaltoshtuese	1 copë	Në pronësi ose me qera	
20	Autobitumatriçe me certifikatë për transport lëndë të rrezikshme	1 copë	Në pronësi ose me qera	
21	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera	
22	Autobetonierë	2 copë	Në pronësi ose me qera	1221 m3 beton
23	Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m3 me targa	1 copë	Në pronësi ose me qira	
24	Fabrikë Betoni e pajisur me leje mjedisore	1 copë	Në pronësi ose me qera	1221 m3 beton

25	GPS/Total Station	1 copë	Në pronësi ose me qera	
26	Makineri /sonde (HDD) per shpim horizontal te drejtuar	1 cope	Në pronësi ose me qera	
27	Betonierë kantieri 0.5m ³	2 copë	Në pronësi ose me qera	
28	Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	500 m ²	Në pronësi ose me qera	1212 m3 beton
29	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera	
30	Vibrator betoni	4 copë	Në pronësi ose me qera	1212 m3 beton
31	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qera	
32	Gjenerator $\geq 3.5\text{kw}$	1 copë	Në pronësi ose me qera	
33	Pompe uji per pastrim	2 copë	Në pronësi ose me qera	
34	Saldatrice	2 copë	Në pronësi ose me qera	
35	Makineri për prerje asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera	

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.
- b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Për autobitumatriçe të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshme.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.
- g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Argumentim Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .”

Konkretisht:

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave të largëta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave ndërmjetëse më të afërta që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit, këto mjete janë për transporte të distancave brenda dhe jashtë kantierit në rast nevojë që të arrihet një ekonomizim i distancës me ngarkesën që mbajnë dhe me kostot e automjetit.
- **Kamioncinë me kapacitet deri në 1.2 - 3.5 ton** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e transportit të materialeve të këtij tonazhi kryesisht brenda dhe jashtë kantierit për furnizime.
- **Minidumper** është një mjet i vogël vetëshkarkues, i projektuar për transportin e materialeve të ndërtimit brenda kantierit ose në terrene të vështira ku nuk mund të lëvizin kamionë të mëdhenj, rruge të ngushta për kthimin e tyre. Gjithashtu do të perdoret në rruge të shtrura në asfalt në fshatrat që do të bëhet shtrirja e linjave të ujesjellesit për mos të demtuar rrugët.
- **Kamiona vetëshkarkues me vëllim me kapacitet mbajtës 5-10 Ton** është i nevojshëm për transportin e dhe shkarkimin e materialeve, si tuba, çimento, hekur dhe çdo material tjetër që do të perdoret në kantiar.
- **Vinç me kosh**, referuar zërit të spostimit të shtyllave mjet i domosdoshëm për elektrikistët për punimet në lartësi
- **Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash** i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore çakëll, granit.
- **Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti** i referohet analizave të preventivit për ngjeshjen e shtresave rrugore asfaltike.
- **Rrul për bankina ngjeshje shtresash** dhe asfalti në pjesën e bankinave.
- **Fadromë dhe minifadromë**, i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit dhe të spostimit të materialeve që do të bëhen në rruge të shtrura në asfalt në fshatrat që do të bëhet shtrirja e linjave të ujesjellesit për mos të demtuar rrugët.
- **Eskavator me zinxhir+ çekiç (matrapik)** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit dhe prishjeve.
- **Eskavator me goma** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit, nevoja e një mjeti me targa lind si pasojë e punimeve në shtresa betoni ose asfaltike pa të demtuar ato.
- **Minifadrome me targa** i referohet preventivit bazë të parashikuar ku përfshihen zërat e gërmimit, nevoja e një mjeti me targa lind si pasojë e punimeve në shtresa betoni ose asfaltike pa të demtuar ato.

- **Grejder me targa** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen shtresat rrugore. Nevoja e një mjeti me targa lind si pasoje e lëvizjes nga sektor në një tjetër në rrugët publike pa i dëmtuar ato. Gjithashtu do të perdoret në rrugë të shtrura në asfalt në fshatrat që do të bëhet shtrirja e linjave të ujësjes për mos të dëmtuar rrugët.

- **Asfaltoshtues dhe Autobitumatrice** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e asfaltimit

- **Autobot uji** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen shtresat rrugore, ku lagia me ujë është domosdoshme për trajtimin e tyre gjithashtu dhe për uljen e pluhurave në zona të banuara.

- **Autobetonierë dhe Autopompë betoni** i referohet preventivit të parashikuar ku përfshihen zërat e betonit.

- **Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m³ me targa:** përdoret për prodhimin, transportin dhe hedhjen e betonit direkt në kantier, pa nevojë për impiant të jashtëm. Funkcioni vetëngarkues mundëson furnizimin autonom me agregate, çimento dhe ujë, duke rritur efikasitetin dhe ulur kohën e punës. Prania e targave lejon qarkullimin në rrugë publike për furnizim më të shpejtë. Ajo siguron beton të freskët dhe të përzier në mënyrë të njëtrajtshme, duke garantuar cilësi më të mirë në realizimin e elementeve të rrugës.

- **Makineri teknologjike për pastrimin e mbetjeve të ujerave të ndotura** mjet i domosdoshëm për pastrimin e linjave ekzistuese të kanalizimeve të lidhura me zërin e ngritjes së pushtave

- **Pajisjet e tjera si betonierë, betoforma, matrapik, vibrator betoni, tokmak, gjenerator, pompë thithëse, Gps, Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke dhe pajisjet e tjera** janë mjete dhe pajisje të lidhura ngushtë me zërat e preventivit.

- **Makineri për prerje asfalti:** përfshihet si mjet i domosdoshëm për prerjen e asfaltit që të bëhet kalimi intersektimit / kalimit të tubave.

- **Makineri /sonde (HDD) për shpim horizontal të drejtuar:** është i domosdoshëm për shpim mikrotuneli referuar zerit 668 në preventiv

Këto makineri janë të justifikuara sepse: mbulojnë të gjitha fazat e ndërtimit të rrugës; mundësojnë punë të njëkohshme në disa fronte; garantojnë cilësi sipas standardeve teknike; ndihmojnë në përmbushjen e afateve kontraktuale dhe rrisin efikasitetin në kantier.

2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

* **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

* **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent**

* **ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë) ose ekuivalent**

* **ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim) ose ekuivalent**

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Shënim: Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Në një zonë si Valiasi (zonë e banuar), kjo është veçanërisht e rëndësishme për të minimizuar ndikimin negativ tek komuniteti dhe mjedisi përreth.

ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigorisë dhe Shëndetit në punë) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigorisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigorisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Punimet e ndërtimit të rrugëve përfshijnë rreziqe të larta (makineri të rënda, trafik, punë në terren). Kjo certifikatë siguron që: të identifikohen dhe menaxhohen rreziqet në kantier, mbrohen punonjësit dhe palët e treta, reduktohen aksidentet dhe incidentet në punë.

ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim), kërkohet për të garantuar që saldimet e Konstrukione metalike të perbera, Pjese speciale gize, që janë të salduar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë, duke siguruar qëndrueshmëri strukturore dhe siguri për përdoruesit duke parë që është një veper ujësjellësi dhe cilesia duhet të jetë e mire standardeve ndërkombëtare .

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 05 04, 17 09 04, 17 03 02, 20 02 02, 20 03 06, në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Ne Ligjin nr. 57 /2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licencuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të rrugës krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

Kodet e kërkuara lidhen specifikisht me zërat e punimeve, si punime gërmimi, prishje, pastrimi i pusëve dhe mbingritjen e tyre, zëra të cilat shkaktojnë mbetje. Kjo garanton që operatori ekonomik mund të grumbullojë dhe transportojë ligjërisht mbetjet e ngurta të rrugës, duke përfshirë metalet e tabelave, betonin, tullat dhe mbeturinat e tjera të kantierit, duke siguruar siguri mjedisore dhe respektim të rregullave ligjore.

Kjo licencë garanton që operatori: respekton legjislacionin mjedisor; transporton dhe depoziton mbetjet në mënyrë të rregullt; shmang ndotjen dhe problemet për komunitetin dhe siguron organizim e siguri më të mirë në kantier.

2.3.13 Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratorit të ketë të akredituara këto teste BS EN 12390-3:2019, BS EN 12390-7:2019, BS EN 480-4:2005, BS EN 12504-2

Argumentim: Kërkesat janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kjo kërkesë është thelbësore për të siguruar kontroll të vazhdueshëm dhe të besueshëm të cilësisë së materialeve ndërtimore, veçanërisht betonit dhe përbërësve të tij.

Përmes këtyre testeve verifikohet rezistenca në shtypje e betonit, cilësia dhe integriteti i strukturës së tij, qëndrueshmëria ndaj reaksioneve kimike dhe deformimeve në kohë, si dhe performanca e aditivëve që përdoren në përzierje. Kryerja e këtyre analizave nga një laborator i akredituar garanton që rezultatet janë të sakta, të verifikueshme dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi.

Në këtë mënyrë, sigurohet që materialet e përdorura në ndërtimin e rrugëve plotësojnë kërkesat e projektit dhe standardet e sigurisë, duke minimizuar rrezikun e defekteve, dëmtimeve të parakohshme dhe kostove shtesë gjatë shfrytëzimit të veprës. Gjithashtu, kjo rrit transparencën dhe besueshmërinë në procesin e zbatimit të punimeve, duke garantuar cilësi dhe jetëgjatësi më të lartë të infrastrukturës.

Agregatet që do të përdoren për prodhimin e betonit ose asfaltit duhet të testohen për potencialin e tyre reagues në prezencë të aklakeve dhe duhet të jenë brenda limiteve të përcaktuara në standartin e aggregateve në beton 1260 duke testuar pre reaktivitetin alkali silica sipas standartit BE EN 812-123. Gjithashtu betoni nuk duhet të ketë segregime të cilat gjatë hedhjes në vepër duhet të testohen sipas BE EN 480-4:2005.:2021, ASTM C1260:2023 ose BS EN 812-123.

2.3.14 Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi**
- ✓ **Matsa uji**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- **Autorizim** të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- **Katalogun** / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut /ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi dhe Matsa uji** të paraqitet certifikatë aprovimi nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që vërteton që tubat dhe rakorderit janë përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm **certifikate akreditimi CE dhe ISO 9001**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjiellësit, matësa

etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipercituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do të sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikun e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”,** si dhe Neni 39, pika 3 e kesaj VKM-je.

2.3.16 Cdo ofertues duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** për punimet në objekt.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, pika 3 dhe pika 8.

Kërkesa që çdo ofertues të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** është thelbësore për një projekt ndërtimi, pasi garanton organizim të mirë të punimeve, përdorim efikas të burimeve dhe respektim të afateve.

Njëkohësisht, Plani i Sigurisë siguron mbrojtjen e punëtorëve dhe publikut, parandalon aksidentet dhe garanton zbatimin e standardeve ligjore gjatë punimeve në rrugë.

Në DST përcaktohet se:

Ndalohet mbështetja në kapacitet e subjekteve të tjera për pikat:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin të punëve të ngjashme

2.3.2 Disponimi i licensës profesionale

2.3.4 Staf kryesor i kualifikuar (drejtuesit Teknik)

2.3.5 Staf mbështetës i kualifikuar

2.3.8 Dhe 2.3.9 Punonjës të specializuar/të kualifikuar

Argumentimi: Kjo procedure karakterizohet nga një vlerë e lartë investimi dhe një rëndësi e veçantë për interesin publik, vlerësohet thelbësore që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të verifikueshme kriteret kryesore të kualifikimit, konkretisht përvojën në punë të ngjashme, stafin drejtues teknik dhe licencën profesionale.

Në rastet kur operatori ekonomik nuk i zotëron vetë këto kapacitete dhe mbështetet në subjekte të tjera, krijohet një ekspozim i konsiderueshëm ndaj riskut të mosrealizimit të kontratës. Kjo për faktin se elementet e sipërpërmendura nuk janë thjesht kriteret formale, por përbëjnë bazën funksionale dhe operacionale për zbatimin me sukses të investimit.

Mungesa e përvojës së drejtpërdrejtë në punë të ngjashme rrit ndjeshëm probabilitetin e gabimeve në planifikim, në menaxhimin e proceseve dhe në përballimin e situatave të paparashikuara gjatë zbatimit. Në projekte me vlerë të lartë (siç është procedura objekt prokurimi), këto mangësi mund të përkthehen në vonesa të konsiderueshme, rritje të kostove dhe ulje të cilësisë së punimeve apo shërbimeve.

Njëkohësisht, mosdisponimi real i stafit drejtues teknik krijon pasiguri mbi aftësinë e operatorit për të menaxhuar kontratën në mënyrë efektive. Nëse ky staf nuk është pjesë organike e operatorit, ekziston rreziku që ai të mos jetë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme ose të tërhiqet gjatë zbatimit, duke sjellë ndërprerje, çorganizim dhe dobësim të kontrollit teknik të projektit.

Po ashtu, mungesa e licencës profesionale në mënyrë të drejtpërdrejtë nga operatori përbën një risk të qartë ligjor dhe operacional. Kjo situatë mund të çojë në pengesa administrative, pezullim të punimeve apo edhe pavlefshmëri të veprimeve të kryera, me pasoja të drejtpërdrejta në ecurinë e investimit.

Duke pasur parasysh vlerën e lartë të kontratës, çdo dështim apo mosrealizim i saj nuk sjell vetëm pasoja për autoritetin kontraktor, por edhe dëm ekonomik dhe social më të gjerë, përfshirë bllokimin e fondeve publike, mosrealizimin e objektivave të projektit.

Në këtë këndvështrim, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera për këto kritere thelbësore rrit ndjeshëm riskun e transferimit formal të kapaciteteve pa garanci reale për disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre efektiv gjatë zbatimit të kontratës.

Për rrjedhojë, për një procedurë me këtë nivel investimi dhe rëndësie, vlerësohet e domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë kapacitetet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë, duke minimizuar rreziqet e mosrealizimit dhe duke garantuar një përdorim efikas dhe të sigurt të fondeve publike.

I. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukurore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara në rikonstruksionin e rrugëve në njësitë administrative. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurta qarkullimi për banorët e zonës.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Komisioni